



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK KAMËZ

Nr. 155 prot.

Kamëz, më 20.11.2024

V E N D I M
Nr. 114 .Datë 20/11 2024
MBI

“MIRATIMIN E PROCEDURAVE PËR ZBATIMIN E PROGRAMIT SOCIAL TË STREHIMIT “SUBVENCIONIMI I INTERESAVE TË KREDISË”, I FINANCUAR ME FONDET E BUXHETIT TË SHETIT”

Këshilli Bashkiak Kamëz i mbledhur sot me datë 20.11.2024, pasi mori në shqyrtim projekt-vendimin Nr.87 Datë 15.11.2024 në mbështetje të nenit 8 pika 2, nenit 9, pika 1, nënpika 1.1, shkronja “b”, nenit 24, nenit 54 shkronja “k”, nenit 55, pikat 2 dhe 6, të ligjit nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, të ndryshuar, nenit 15 dhe nenit 47, të ligjit nr. 22/2018, “Për strehimin social” të ndryshuar, vendimit nr. 384, datë 12.06.2019, të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e dokumentacionit për të përfutur strehim sipas çdo programi social të strehimit dhe të afateve e të procedurave të miratimit nga organet e vetëqeverisjes vendore”, vendimit nr. 453, datë 3.7.2019, të Këshillit të Ministrave “Për masën e subvencionit të interesave të kredisë dhe procedurën e dhënies së tij për familjet që përfitojnë banesë me kosto të ulët, me kredi të lehtësuara nga shteti”, VKB nr.44 datë 13.04.2022 “Për miratimin e procedurave lidhur me programin social Subvencioni Interesave të Kredisë”, **Këshilli Bashkiak Kamëz**”;

V E N D O S I:

1. Miratimin e procedurave për zbatimin e programit social të strehimit, "Subvencionimi i interesave të kredisë", i financuar me fondet e buxhetit të shtetit, sipas udhëzuesit operacional, të ndryshuar bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e këtij vendimi.
2. Sistemin e pikëzimit bashkëlidhur, këtij vendimi.
3. Shfuqizimin e Vendimit nr.44 datë 13.04.2022 “Për miratimin e procedurave lidhur me programin social Subvencioni Interesave të Kredisë” dhe të ngelet në fuqi ky vendim lidhur me “Subvencionimi i interesave të kredisë”, i financuar me fondet e buxhetit të shtetit, sipas udhëzuesit operacional, të ndryshuar bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e këtij vendimi.
4. Ky vendim hyn në fuqi pas **konfirmimit ligjor nga Prefekti i Qarkut Tiranë.**

KRYETAR KËSHILLI
Hysen KOLDASHI